



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 , dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E SERRAVE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Përkrahen 100 (njëqind) fermerë të Komunës së Podujevës në projektin në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e serrave nga 100 m².

Neni 2

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e vendimit.

Neni 3

Ndarja e serrave bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nr. 02-320/01-0038702/17

Podujevë,
22 maj 2017



Kryetari i Komunës
Agim Veliu